



MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE

Nr. 348 prot.

Tiranë, më 20.01.2021

Lënda:

RAPORTIM VJETOR

Drejtuar:

ZNJ. XHEMALI

ZV. MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

E nderuar, znj. Xhemali,

Për vitin 2020, nga ana e Agjencisë së Trajtit të Kredive, pavarësisht situatës së krijuar për shkak të pandemisë, ka vijuar puna nga i gjithë stafi i ATK-së me qëllim realizimin e detyrave dhe realizimin e arkëtimeve sipas planifikimit të vendosur nga Këshlli Mbikqyrës. Me gjithë vështirësitë u arrit që të arkëtohen 50,805 milion All nga 80,000 milion All ose 64% e planit vjetor.

Vlenë të theksojmë që gjatë këtij viti është negociuar dhe firmosur marrveshje bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë, për regjistrimin e të gjithë debitorëve të ATK-së në regjistrin e kredive, marrëveshje e cila shpresojmë të japi një ndikim pozitiv në rritjen e arkëtimeve duke filluar nga viti 2021.

Gjatë mbledhjes së fundit të Këshillit Mbikqyrës është miratuar edhe buxheti për vitin 2021, ku parashikohet një rritje e të ardhurave në 90,000 milion All. Ky parashikim me rritje vjen si rezultat i punës së kryer gjatë vitit 2020 dhe pritshmërvive për mbylljen e disa kredive me vlera domethënëse, por edhe marrëveshjeve që jemi duke diskutuar me disa institucione të tjera shtetërore që do t'i rendisim më poshtë.

➤ **Problematikat e hasura gjatë procesit të punës dhe priorititetet për zgjidhje gjatë vitit 2021**


Duke qenë se portofoli i ATK-së sa vjen dhe amortizohet po ju përmendim disa shifra. Aktualisht në portofolin e ATK-së janë rreth 11200 debitorë aktiv, nga të cilët rreth 4000 mijë debitorë ose 35% janë deri në 50,000 lekë, rreth 2272 dosje janë me mungesë të theksuar dokumentacioni. Kreditë janë dhënë përpara vitit 1997, dokumentacioni në disa banka të



**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE**

qyteteve të Shqipërisë u dogj dhe shkatërrua, si pasojë e trazirave të '97. E vjetmja e dhënë përkthetë debi është procesverbali i transferimit. Vështirësi në mbledhjen e kredive krijon edhe mosha e debitorëve pasi janë hasur shumë raste ku gjatë kësaj periudhe kanë ndërruar jetë.

- Mungesa e përgjigjeve nga ASHK-të rajonale (aplikimet e kryera nga 2013 dhe përgjigjet 2019 ose pa përgjigje).
Nevojitet bashkëpunim me ASHK-në, për përshpejtimin e afateve të kthimit të përgjigjeve me qëllim trajtimin e debitorëve dhe rritjen e arkëtimeve.
- Mungesë informacioni për saktësimin e adresave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile.
Kërkojmë akses të drejtpërdrejtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjëndjes Civile e cila do t'i vinte në ndihmë të ATK-së lidhur me identifikimin më të fundit të adresave të debitorëve apo edhe vënies në dispozicion të ID-ve të tyre, të cilat do ta lehtësonin procesin e vjeljes së detyrimeve që debitorët kanë ndaj ATK-së.
- Mungesa e numrit të kontaktit të debitorëve është një tjetër pengesë, një marrëveshje e rëndësishme do të ishte edhe ajo me AKEP për numrat e kontaktit të debitorëve.
- Mungesë informacioni për pasuritë e luajtshme të regjistruara pranë DPSHTRR.
Kërkojmë marrëveshje bashkëpunimi ose akses të drejtpërdrejtë në sistemin e DPSHTRR-së me qëllim identifikimin e pasurive të luajtshme që mund të disponojnë debitorët.
- Nevojitet krijimi i një bashkëpunimi me Postën Shqiptare kryesisht me Drejtoritë Rajonale për shkak të problematikave të vazhdueshme që kemi me njoftimet të cilat na pengojnë vijimin e procedurave ligjore.
- Në funksion të realizimit të arkëtimeve kërkojmë të krijojmë mundësinë për marrëveshje bashkëpunimi me OSHEE për saktësimin e adresave dhe evidentimin e tyre në terren.



**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE**

Sipas vlerësimit tonë fokusi i punës së Agjencisë së Trajtit të Kredive duhet të jetë identifikimi i debitorit dhe kontaktimi i tij. Në këtë mënyrë do të krijohet një e dhënë e saktë mbi gjendjen ekonomiko-sociale të tij duke nxjerrë edhe pritshmëritë e kthimit të detyrimit. Vlerësimi i punës së stafit nuk mund të jetë më vetëm nëpërmjet arkëtimeve, por edhe puna për analizën reale të borxhit të mbetur si dhe trajtimi ligjor, deri në vjeljen e plotë të detyrimit. Nëpërmjet organizimit të brendshëm të punës sistematike dhe forcimit të kërkesës së llogarisë, frysës së bashkëpunimit mes sektorëve do të krijojmë bindjen, se informacioni i mirë dhe kontrolli përbëjnë çelësin e suksesit në të ardhmen. Vetëm në këtë këndvështrim tërësor, plani strategjik i ATK-së mund të jep efektin e duhur për drejtimin e inistucionit në vazhdim dhe realizimin e funksionit me sukses.

Nga sa më sipër, duke Ju falënderuar bashkëpunimin e vazhdueshëm,

Me konsideratë të veçantë,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

